



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren  
Prizren Belediyesi  
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine  
Belediye Başkanı

01 Nr. 167/25 Dt. 06.03.2025



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

<b>Data/Date:</b>	<b>06.03.2025</b>
<b>Për/Za/To:</b>	Shaqir Totaj, Kryetar i Komunës së Prizrenit
<b>CC</b>	Antigona Bytyqi, Kryesuese e Kuvendit Komunal të Prizrenit
<b>Tema/Subjekat/Subject</b>	Raporti (me komente) për ecurinë e konsultimit për raportin për: Projekt-Rregulloren për Transparencë Komunale për Komunën e Prizrenit

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna me theks neni 30-Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

-Me **04.12.2024**, kryetari i Komunës, Shaqir Totaj ka formuar grupin punues për Hartimi e Projekt- Rregulloren për Transparencë Komunale për Komunën e Prizrenit. Anëtarët e këtij grupi janë: Ymer Berisha, kryesues; Eleonora Fetollari-Bush, anëtare; Adelina Hoxhaj, anëtare; Dafina Ukallo, anëtare; Emine Gashi, anëtare; Blerim Rakaj, anëtarë; Naim Kukaj, anëtar; Haziz Krasniqi, anëtarë; Fisnik Minci, anëtarë; Eroll Shabani anëtar (OJQ EcMaNdryshe) dhe Adem Kollari, anëtar i jashtëm nga OSBE.

**Publikimet:**

Publikimet janë bërë me **13.02.2025** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/02/Njoftim-per-organizimin-e-KONSULTIMIT-publik-per-Rregulloren-per-Transparence-ne-Komunen-e-Prizrenit-Shq-Bosh-Tur.pdf>

Në platformë:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42774>

Njoftimi si lajm në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-rregulloren-per-transparence-ne-komunen-e-prizrenit/>

Njoftimi në Facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/1DxZL2j112/>

**Me 14.02.2025**, njoftimi dhe projekt-rregullorja (në tri gjuhë) u është dërguar përmes emailit, qytetarëve, klubet sportive, OJQ, organizata të ndryshme, drejtor të shkollave, bizneseve, organizatat studentore, ekspert të fushave, mediat lokale, shoqatave të ndryshme si dhe organizata rinore, që të kenë mundësi të njihen më detajshëm me dokumentin në fjalë, sepse disa nga ta nuk kishin pasur mundësi ta lexonin të publikuar në ueb faqe.

**Me 21.02.2025**, është mbajtur konsultimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e konsultimit:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/u-mbajt-konsultim-publik-me-qytetare-per-projekt-rregulloren-per-transparence-ne-komunen-e-prizrenit/>

Në facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/19trpDh7pb/>

**Me 03.03.2025**, është publikuar procesverbali për mbajtjen e konsultimit publik, procesverbali është i publikuar në këtë vegëz:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/03/Procesverbali-per-projekt-Rregulloren-per-Transparence-Komunale-ne-Komunen-e-Prizrenit-PDF-SCAN.pdf>

Dokumenti ka qenë në konsultim publik në uebfaqen zyrtare të komunës dhe platformën e konsultime publike, nga data **13.02.2025** deri me **28.02.2025**, ndërsa komentet janë pranuar deri me datë **28.02.2025**.

**Tabelori me të dhëna të shkurtra:**

Metodat e konsultimit	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime	Numri i kërkesave
1-Takime i drejtpërdrejtë me qytetarë për Raporti për: Projekt-Rregulloren për Transparencë Komunale për Komunën e Prizrenit	<b>21.02.2025</b> Nga-11:10 Deri-11:40	F M T 10 17 27	7	0-Pjesërisht 0-Refuzohen 5-Pranuara 2-Adresuar

Nr	Kërkesat /Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë/ sugjerim	Statusi i kërkesës: Pranuar: Pjesërisht: Refuzuar: Adresuar	Komisioni ka mbajtur takim me: <b>06.03.2025</b> për shqyrtimin e komenteve/kërkesave të pranuar nga qytetarët
1	Kërkoj që gjatë festave shtetërore përshak të diversitetit etnik të vendoset edhe flamuri Turk.	<b>Haki Reshtana-</b> Koment i pranuar në konsultim publik	<b>Adresohet</b>	Organizimi i festave shtetërore dhe të tjera, organizohet nga ligji për festat zyrtare në nivel të Republikës së Kosovës. Por kërkesa juaj, do të provojmë që ta implementojmë gjatë festave në territorin e komunës sonë.
2	Çdo vendim duhet me përkthehet edhe në gjuhën boshnjake dhe turke. Këtu e kenë pak një mangësi.	<b>Admir Bajrami-</b> Koment i pranuar në konsultim publik	<b>Aprovohet</b>	Të gjitha vendimet e kuvendit dhe kryetarit të komunës, përkthehen në gjuhët zyrtare të komunës dhe tek pastaj publikohen në uebfaqen zyrtare të komunës së Prizrenit.

3	Se herë po, po vij në mbledhje, po ma japin fjalën. Ju përshëndes për punën, i përgëzoj për të gjitha, sa më shumë kritika prej neve, mendoj që ju do të punoni pak më shumë.	<b>Dashnor Vehapi-</b> Koment i pranuar në konsultim publik	<b>Aprovohet</b>	Për komunën tonë bashkëpunimi me qytetarët rrit cilësinë e vendimmarrjes në komunë dhe rrit besimin në mes të komunës dhe qytetarëve.
4	Kam pasur rastin të shikoj domethënë dokumentin edhe vërej që është me të vërtetë një punë shumë e mirë edhe uroj që ta gëzojtë gjithë banorët e komunës së Prizrenit.	<b>Linda Simitçiu-</b> Koment i pranuar në konsultim publik	<b>Pranohet</b>	Bashkëpunimi me OJQ-të dhe kontributi i tyre në hartimin e dokumenteve është i çmueshëm për komunën, ndaj sigurisht që edhe në aktivitetet tjera do të rrugëtojmë bashkë me OJQ-të.
5	Deshta t'ju them edhe një herë për zotërinj, Sherif Qerimi, i cili është i vetëm te rruga Mehmet Hasi ju kisha lutur mos e lëni në vetëmij se vetë që ai nuk e di qysh jeton.	<b>Resmie Krasniqi-</b> Koment i pranuar në konsultim publik	<b>Adresohet</b>	Shqetësimet e qytetarëve i konsiderojmë me seriozitetin institucional ndaj në të gjitha kërkesat tuaja, do të angazhojmë personel nga drejtoritë adekuate dhe kohë sa më të shkurtër do të adresohet të gjitha kërkesat tuaja.
6	Kur flasim për transparencën, ftesa na ka ardhur me kohë për këtë takim për sot, por po befasohej që në këtë takim ne jemi diku 40-42 kryetarë të bashkesive lokale, po shoh më shumë ka të organizatave jo qeveritare të cilat po merren me problematikën e me nevojën të qytetarëve sesa na, tash po them edhe për vete, sesa ne që jemi të zgjedhur për me votën e popullit për me mbrojtë edhe interesat e qytetarëve por edhe për shërbime të tjera që kanë nevojë qytetarët.	<b>Simon Veseli-</b> Koment i pranuar në konsultim publik	<b>Pranohet</b>	Ftesat dhe njoftimet janë bërë me kohë, shqetësimi juaj është i vlerësuar dhe i drejtë shpresojmë që në takimet tjera edhe kryetaret tjerë të këshillave lokale do të jenë më aktiv në mbrojtje të kërkesave të zonave që i përfaqësojnë.

7	Pasi qe vije nga Landovica me rastin e përvjetorit te Pavarësisë kemi pas mysafir nga vendet e ndryshme ne Varrezat e Landovices. Flamujte janë te dëmtuar dhe duhet përgjegjësit adekuate te merren me këtë punë.	<b>Faik Berisha-</b> Koment i pranuar në konsultim publik	<b>Adresohet</b>	Kërkesën tuaj do të adresojmë tek njësia e logjistikës e cila është në kuadër të drejtorisë së Administratës. Vlerësojmë shqetësimet tuaja do të zgjidhen në afat sa më të shkurtër kohohë.
---	--	--	------------------	---

Në këtë vegëz: <https://www.facebook.com/watch/?v=967799142115917&rdid=KmW4q7xsE8HasjGA> , mund të gjeni video incizimin e konsultimit publik.

**Shkurtesat:**

F-Femra

M-Meshkuj


T-Totali

**Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:**

1. Njoftimin për mbajtjen e konsultimit publik,
2. Lista e nënshkrimeve e anëtarëve të komisionit,
3. Vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e rregullores,
4. Lista e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik,
5. Lista e anëtarëve të komisionit për takimin e mbajtur për shqyrtimin e komenteve/kërkesave.

Raporti është përgatitur nga :

Haziz Krasniqi






## NJOFTIM PUBLIK

Njoftohen të gjithë banorët e Komunës së Prizrenit për organizimin e konsultimit publik për Projekt-Rregulloren për Transparencë në Komunën e Prizrenit.

**Data : 21.02.2025**

**Vendi: Salla e mbledhjeve të Kuvendit Komunal (Shtëpia e Bardhë)**

**Ora : 11:00**



Të dashur qytetarë/e,

Komuna e Prizrenit përmes grupit punues për hartimin e Projekt-Rregullores për Transparencë në Komunën e Prizrenit, duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Prizrenit. Nr. 01/011-5643 dhe Udhëzimet Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, lëshon këtë:

### NJOFTIM PUBLIK

Lidhur me organizimin e konsultimit publik me qytetarë për Projekt-Rregulloren për Transparencë në Komunën e Prizrenit

Ky dokument do të jetë në konsultim publik nga **13.02.2025** deri me datën: **28.02.2025**, ndërsa konsultimi publik me qytetarë do të mbahet me **21.02.2025**, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal (Shtëpia e Bardhë) me fillim në ora **11:00**.

Komentet dhe sugjerimet mund t'i dërgoni deri me datën **28.02.2025** në ora **16:00**, në emailat e zyrtarëve: [Adelina.Hoxhaj@rks-gov.net](mailto:Adelina.Hoxhaj@rks-gov.net) dhe [Haziz.Krasniqi@rks-gov.net](mailto:Haziz.Krasniqi@rks-gov.net).

Për më shumë detaje për rregulloren, mund t'i vizitoni vegëzat e mëposhtme:

Uebfaqen zyrtare në rubrikën rregulloret në konsultim publik:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/category/konsultime-publike/rregulloret-ne-konsultim-publik/>

Platformën për Konsultime Publike:

<https://konsultimet.rks-gov.net/>

Facebook:

<https://www.facebook.com/kkprizren>


Ymer Berisha

Udhëheqës i Njësisë për Komunikim me Publikun



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren  
Prizren Belediyesi  
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine  
Belediye Başkanı

01 Nr. 128/25 Dt. 13.02.2025



## JAVNO OBAVEŠTENJE

**Obaveštavaju se svi građani Opštine Prizren za organizovanje javne konsultacije Projekat-Pravilnika za Transparentnost u opštini Prizren.**

**Dana: 21.02.2025**

**Mesto: Sala za sastanke  
Skupštine Opštine (Bela Kuća)**

**Vreme: 11:00**

Poštovani građani,

Opština Prizren je preko radne grupe za izradu projekt-pravilnika za transparentnost u opštini Prizren, na osnovu Zakona br. 03/L-040 za Lokalnu Samoupravu, Statut opštine Prizren. br. 01/011-5643 i Administrativnog uputstva (MALS) br. 04/2023 za Otvorenu Administraciju u Opštinama, obaveštava:

### JAVNO OBAVEŠTENJE

U vezi sa organizovanjem javnih konsultacija sa građanima za Projekat-Pravilnik za Transparentnost u opštini Prizren

Ovaj dokument će biti na javnoj konsultaciji od **13.02.2025.** do datuma: **28.02.2025.** godine, dok će se javna konsultacija sa građanima održati **21.02.2025.** godine, u sali za sednice Skupštine opštine (Bela kuća) sa početkom od **11:00** časova.

Vaše komentare i sugestije možete slati do datuma **28.02.2025** u **16:00**, na e mail službenika: [Adelina.Hoxhaj@rks-gov.net](mailto:Adelina.Hoxhaj@rks-gov.net) i [Haziz.Krasniqi@rks-gov.net](mailto:Haziz.Krasniqi@rks-gov.net).

Za više detalja o dokumentu, možete posetiti linkove:

Službeni portal u rubrici planovi na javnoj konsultaciji:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/category/konsultime-publike/planet-ne-konsultim-publik/>

Platforma za javne konsultacije:

<https://konsultimet.rks-gov.net/>

Facebook:

<https://www.facebook.com/kkprizren>


Ymer Berisha

Rukovodilac Jedinice za Odnose sa Javnošću



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren  
Prizren Belediyesi  
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine  
Belediye Başkanı

01 Nr. 128/25 Dt. 13.02.2025



## KAMU BİLDİRİSİ

**Prizren Belediyesi'nin tüm sakinleri, Prizren Belediyesi'nde Şeffaflık Yönetmeliği Taslağı ile ilgili kamuya açık istişare toplantısının düzenleneceği konusunda bilgilendirilir.**

**Tarih: 21.02.2025**

**Yer: Belediye Meclis toplantı salonunda (Beyaz Ev)**

**Saat: 11:00**

Sevgili vatandaşlar,

Prizren Belediyesi, 03/L-040 Sayılı Yerel Yönetimler Kanunu, Prizren Belediyesinin 01/011-5643 Sayılı Tüzüğü ve Belediyelerde Açık Yönetime İlişkin 04/2023 Sayılı İdari Talimatı (YYİB) dayanarak, Prizren Belediyesi'nde Şeffaflık Yönetmeliği Taslağı hazırlanmasına yönelik çalışma grubu aracılığıyla aşağıdaki bildiriye yayımlar:

### KAMU BİLDİRİSİ

Prizren Belediyesi'nde Şeffaflık Yönetmeliği Taslağı için kamu tartışma düzenlenecektir

İşbu belge **13.02.2025** tarihinden **28.02.2025** tarihine dek kamu tartışmasına açıktır, vatandaşlarla kamu tartışma ise **21.02.2025** günü Belediye Meclisi oturum salonundan (Beyaz Evde) saat **11:00'den** başlayarak düzenlenecektir.

Talep, yorum ve önerilerinizi **00.02.2025** günü saat **16:00'**ya kadar, devamdaki resmi e-postalara iletebilirsiniz: [Adelina.Hoxhaj@rks-gov.net](mailto:Adelina.Hoxhaj@rks-gov.net) ve [Haziz.Krasniqi@rks-gov.net](mailto:Haziz.Krasniqi@rks-gov.net).

Yöntemlik hakkında daha fazla bilgiye aşağıdaki bağlantılardan ulaşabilirsiniz:

Belediyenin resmi internet sayfasında Kamu Tartışma Planları bölümü:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/category/konsultime-publike/planet-ne-konsultim-publik/>

Kamu Tartışma Platformu:

<https://konsultimet.rks-gov.net/>

Facebook:

<https://www.facebook.com/kkprizren>

Ymer Berisha  
Halkla İletişim Birimi Yöneticisi



REPUBLIKA E KOSOVËS \* REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURİYETİ  
Komuna e Prizrenit \* Opština Prizren  
Prizren Belediyesi  
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine  
Belediye Başkanı

01 Nr. 128/25 Dt. 13.02.2025





REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren  
Prizren Beledijesi  
Kryetari i Komunës • Председник Општине  
Belediye Başkanı



01 Nr. 742/24 Dt. 04.12.2024

Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M Për formimin e Grupit Punues

- Formohet dhe emërohet Grupi Punues për hartimin e Draft-Rregullores për Transparencë komunale në Komunën e Prizrenit. Anëtarë të këtij Grupi Punues, emërohen:
  - Ymer Berisha .....kryesues,
  - Eleonora Fetollari Bush, .....anëtare,
  - Adelina Hoxha,.....anëtare,
  - Dafina Ukallo.....anëtare,
  - Emine Gashi, .....anëtare,
  - Blerim Rakaj,.....anëtar,
  - Naim Kukaj,.....anëtar,
  - Haziz Krasniqi, .....anëtar,
  - Fisnik Minci, .....anëtar, gazetar,
  - Eroll Shabani,.....anëtar, Ec Ma Ndryshe,
  - Adem Kollari,.....anëtar i jashtëm nga OSBE,
- Detyrat e Grupit Punues të emëruar si në pikën 1 të këtij Vendimi është që në afat sa më të shkurtër kohor të hartoj Draft Rregulloren për Transparencë komunale në Komunën e Prizrenit, në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe pas hartimit të draftit përkatës, ti procedohet organeve kompetente për shqyrtim dhe miratim.
- Obligohet Njësia për Komunikim me Publikun dhe Grupi Punues për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës  
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Njësia për Komunikim me Publikun,
- Grupit Punues,
- Arkivës së Kryetarit.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Lista e nënshkrimeve e qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik për: Rregulloren për Transparencë në Komunën e Prizrenit-.

Emaili dhe numri i telefonit do të përdoren për t'ju dërguar njoftime-ftesa për organizimin e konsultimeve, takimeve dhe dëgjimeve publike.

Data e mbajtjes së konsultimit: 21.02.2025.

Nr.	Emri	Mbiemri	Nr.Tel	Email	Gjinia	Nënshkrimi
1	ALMIR	BAJRAMI	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
2	FARK	BEKRI	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
3	ISMET	KUSHTI	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
4	HAKI	KASTANA	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
5	Remrije	Krasniqi	[REDACTED]	[REDACTED]	F	[Signature]
6	BERIM	TRACI	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
7	Eleonora	Fetllari	[REDACTED]	[REDACTED]	F	[Signature]
8	Adelina	Hoxhaj	[REDACTED]	[REDACTED]	F	[Signature]
9	Dafina	Ukallo	04 [REDACTED]	dafina [REDACTED]	F	[Signature]
10	Arinda	Rauq	[REDACTED]	[REDACTED]	F	[Signature]
11	Lemolizi	Namli	[REDACTED]	[REDACTED]	F	[Signature]
12	Siman	Verli	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
13	Omer	Beqiri	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
14	Bademe	Baligi	[REDACTED]	[REDACTED]	F	[Signature]
15	Yunus	Prentex	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Lista e nënshkrimeve e qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik për: Rregulloren për  
Transparencë në Komunën e Prizrenit.

Emaili dhe numri i telefonit do të përdoren për t'ju dërguar njoftime-ftesa për organizimin  
e konsultimeve, takimeve dhe dëgjimeve publike.

Data e mbajtjes së konsultimit: **21.02.2025.**

Nr.	Emri	Mbiemri	Nr.Tel	Email	Gjinia	Nënshkrimi
1	DASHMIR	VEHA	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
2	LINDA	SIMITI	[REDACTED]	[REDACTED]	F	[Signature]
3	BASKIRI	RAKOTI	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
4	VALON	SOPE	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
5	Blairim	Rokaj	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
6	HALID	KAPADJANI	[REDACTED]	halidkucenoluni@gmail.com	M	[Signature]
7	Salih	Bytyqi	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
8	Elvira	Elshani	[REDACTED]	[REDACTED].com	F	[Signature]
9	QAZIM	THACI	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
10	HARIZ	KRASHI	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
11	Barbara	Hoti	[REDACTED]	[REDACTED]	F	[Signature]
12	Enver	Thaçi	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
13						
14						
15						



REPUBLIKA E KOSOVËS \* REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit \* Opština Prizren  
Prizren Belediyesi  
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine  
Belediye Başkanı

01 Nr. 158/25 Dt. 03.03.2025



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

## Procesverbali për Projekt- Rregulloren për Transparencë Komunale për Komunën e Prizrenit

**Publikimet:**

Publikimet janë bërë me **13.02.2025** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/02/Njoftim-per-organizimin-e-KONSULTIMIT-publik-per-Rregulloren-per-Transparence-ne-Komunen-e-Prizrenit-Shq-Bosh-Tur.pdf>

Në platformë:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42774>

Njoftimi si lajm në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-rregulloren-per-transparence-ne-komunen-e-prizrenit/>

Njoftimi në Facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/1DxZL2j112/>

**Me 14.02.2025**, njoftimi dhe projekt-rregullorja (në tri gjuhë) u është dërguar përmes emailit, qytetarëve, klubet sportive, OJQ, organizata të ndryshme, drejtor të shkollave, bizneseve, organizatat studentore, ekspert të fushave, mediat lokale, shoqatave të ndryshme si dhe organizata rinore, që të kenë mundësi të njihen më detajshëm me dokumentin në fjalë, sepse disa nga ta nuk kishin pasur mundësi ta lexonin të publikuar në ueb faqe.

**Me 21.02.2025**, është mbajtur konsultimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e konsultimit:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/u-mbajt-konsultim-publik-me-qytetare-per-projekt-rregulloren-per-transparence-ne-komunen-e-prizrenit/>

Në facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/19trpDh7pb/>

## **Konsultimi ka filluar në orën 11:10**

Ymer Berisha-Udhëheqës i Njesisë për Komunikim me Publikun ka hapur konsultimin publik duke thënë se jemi në konsultim publik për rregulloren për transparencë përmes të cilës mëtojmë të rrisim transparencën, përgjegjshmërinë e komunës së Prizrenit, para qytetarëve të saj, me të vetmin qëllim që politikat publike të jenë të konsultuara me kohë para se dokumenti të në këtë sallë, në këtë institucion dhe pastaj secila drejtori. Kryetarit të komunës dhe deri te nivelet më të ulëta administrative janë të obliguara që të zbatojnë të gjitha të gjeturat që i përmbana dokumenti në fjalë.

Kryetari Totaj ka kërkuar që zyra jonë të jetë kons

Atëherë, të nderuar qytetarë, kam kënaqësinë që në emrin e kryetarit të komunës zoti Shaqir Tota të përshëndes pranimin tuaj sot në këtë konsultim publik për një dokument i cili meton që të rrisë transparencën, llogaridhënien, përgjegjshmërinë e komunës së Prizrenit para qytetarëve të saj. Me të vetmin qëllim që politikat publike të jenë të konsultuara me kohë para se dokumentat të miratohen në këtë sallë, në këtë institucion dhe pastaj secila drejtori prej kryetarit të komunës dhe deri të nivelet më të ulëta administrative janë të obliguar që të zbatojnë të gjitha të gjeturat që i përmban dokumentin në fjalë që sot e kemi rregulloren për transparencë. Kryetari tonë i ka kërkuar që zyra jonë të jetë konsekuente me kërkesat që vijnë gjatë viteve dhe dekadave në vijim dhe komuna e Prizrenit të jetë prioritare në përmbushjen e kërkesave të qytetarëve sa i përket transparencës së llogaridhënies dhe ushtrimit të përgjegjësive në të gjitha nivelet e mundshme që ka komuna. Ky dokument që e kemi nxjerrë në diskutim publik dhe e kemi konsultuar me një komision profesional që është në përbërje nga zyrtarë të komunës, të organizatave, të shoqërisë civile dhe gazetarë.

Qëllimi ka qenë që me parë cilat janë thirrjet e grupeve të ndryshme shoqërore adresuar komunës së tyre për të përmbushur kërkesën që e gjithë vendimmarrja e komunës sonë të jetë transparente, të jetë e hapur me mundësi diskutimi para se vendimmarrja të formalizohet në institucionet e komunës ose në në komunën në përgjithësi.

Prania juaj sot fizike këtu dëshmon se jemi bashkë në këtë rrugëtim dhe besoj shumë se vetëm së bashku me qytetarët, kërkesat e tyre, nevojat do të marrin vendime të drejta, do ta implementojmë demokracinë

vendimmarrëse si mënyrë e organizimit të punës në komunë, do të jemi besnikë ndaj njëri-tjetrit, të gjitha palët do të mundohemi të shkojmë në një drejtim të kënaqësisë sa më të madhe që është e mundur, të dëgjohet zëri i qytetarëve, por ne normalisht e ruajmë të drejtën se komuna duhet të gjithë vendimmarrjen ta ketë të bazuar vetëm në mbështetje të ligjit.

Ligji për vetëqeverisjen lokale është një farë kushtetute për komunat e Kosovës dhe pastaj administrohen disa shërbime të tjera dhe me disa ligje të tjera që është ligji i financave publike, ligji i organizimit të administratës publike e kështu me radhë. Domethënë ne si komunë e ruajmë kujdesin maksimal që zëri i qytetarëve i cili ka hapësirë që të integrohet në ligjet e Republikës së Kosovës, kushtetutën e Republikës së Kosovës, do të jemi të kënaqur kur ne mund t'i ofrojmë një shërbim qytetarit në këtë nivel.

Për arsyen e vetme se metimi ynë është që në secilën fushë të jetës të përmirësohet cilësia e jetës sonë gradualisht. Në këtë rast sot kemi këtë rregullore, e cila e mban qytetarin përgjegjëse dhe kryetarin e komunës së përgjegjshëm për gjithë vendimmarrjen e tij. Ka afate kohore ligjore kur komuna duhet t'i bëjë publike thirrjen llojeve të veta, njoftimet qoftë për mbledhje të kuvendit, qoftë për mbledhje të kryetarit të komunës, qoftë për agjendën ose protokollin që lidhet me komunën ekskluzivisht ose edhe me njësi të tjera administrative çfarë është niveli qeveritar, pastaj niveli diplomatik. Thjesht ky dokument meton që ta organizojë punën sa është më mirë që është e mundur. Me të vetmin qëllim pra që komuna e Prizrenit, vendimmarrja në komunën e Prizrenit të jetë e hapur për të gjitha audiencat mundshme, relevante të cilat veprojnë rreth një qëllimin të caktuar. Për të realizuar këtë të drejtë, ky dokument nuk përmbillet me këtë konsultim sot. Është i hapur edhe për audiencat online dhe deri me datën 28 shkurt 2025 të gjithë qytetarët të cilët nuk janë sot këtu, po përmes mjeteve të informimit mund ta marrin informacionin se dokumenti është në konsultim publik, mund të japin idetë, gjetjet e tyre, sugjerimet e tyre që e pasurojnë dokumentin dhe ne do i mirëpresim. Normalisht kemi një falënderim si komision në drejtim të OSBE-së, pasi zoti Kollari ka dhënë një kontribut të çmuar, pastaj të mediat, të gazetari Fisnik Minci që mund ta vlerësoj si emër i cili ka dhënë një kontribut gjatë këtyre mbledhjeve të komisioneve, sot jemi me prani fizike në këtë konsultim.

Pastaj dokumenti normalisht do të shkon në drejtim trendit të komunës e Prizrenit dhe unë do të gjej mundësinë që sëbashku me kryesuesin dhe kryetarin ta qesim si pikë të rendit të ditës në seancat vijuese. Kështu që edhe partitë opozitare shqiptarë e kanë shansin e tyre që të japin fjalët e tyre, idetë e tyre për dokumentin dhe pastaj unë besoj gjithmonë se ky dokument ka një historik të kaluar, është votuar gati në mënyrë unanimit nga të gjithë asamblistët me qëllimin e vetëm se të gjithë janë për të arrijë transparencën.

Jemi duke ruajtur fokusin në informacion për ju dhe qytetarët se e shehni krejt bota është duke u transformuar sa i përket këtyre vendimmarrjeve. Dita që ka lënë ligji po forcohet dhe nuk mbetet diskrecion njerëzor shumë i madh për arsye se e kemi edhe tendencën e inteligjencës artificiale.

Tani kërkesat e qytetarit botëror po edhe këtij të komunës së Prizrenit është që kryetari është i tyre, vendimmarrja është e tyre dhe së bashku ata duhet të administrojnë paratë që i vijnë në buxhetin e komunës së Prizrenit, paratë e taksa paguesve dhe burimet njerëzore.

Këto dy kategori e kanë për qëllim që kryetarin e komunës domethënë të jetë sa më aktiv në mënyrë që edhe sa më racional, sa më i drejtë që edhe paratë edhe njerëzit të maksimalizohen mundësitë për realizimin të projekteve, të maksimalizohet dija njerëzore.

Mirëpo po them, vullneti ynë është shumë i madh që ta dëgjojmë qytetarin dhe bashkë me ta të bëjmë më të mirën për të gjithë në sëbashku. Hazizi më njofton mua që dokumentin të organizatat e shoqërisë civile e ka dërguar në mënyrë elektronike.

Tash ne po promovojmë thashë standarde të ditëve edhe ne në vijim i kemi ikur pak letrës kopje të fortë për më mos me shpenzuar shumë letrar e tjera e tjera, për me e nxit, domethënë qytetarin tonë, të rinjtë edhe të rejtat tona që të komunikojnë në mënyrë elektronike më shumë, që të jemi më racionale, të kemi informacion në kohën e duhur.

Dokumenti pra po them, ka qenë i qashtëm atje, i përmban dhe e mban në obligim kryetarin e komunës qoftë edhe për një mbledhje të rregullt të kuvendit, qoftë për një mbledhje të jashtëzakonshme, qoftë për një mbledhje solemne, që këto organizohen kur ka ditë festash kombëtare ose shpallje të ndonjë qytetari nderi e të tjera e tjera.

Domethënë të gjitha këto veprime, zyra për komunikim me publikun, i ka afatet ligjore që e njoftojnë qytetarin e bën të ditur kur do të ndodhë ora, vendi, saktë se çfarë, çfarë do të, çfarë do aktiviteti do të ketë. Por fokusi kryesor i rregullores është po ashtu që domethënë politikat e tenderimit dhe politikat e punësimit, meqë janë dy targete ku qytetarët pak më shumë kanë interes, jemi munduar që t'i bëjmë sa më të hapura.

Konkurrenca të jetë e barabartë për të gjithë, mundësitë të jenë të barabarta për të gjithë dhe meritokracia të jetë standard i cili rrugëton drejt realizimit të projekteve ose drejt të drejtave të punësimit. Unë besoj që para jush e kemi sjellë një dokument serioz, profesional dhe ligjor dhe besoj se ky dokument do ta ndihmojë



kryetarin dhe gjithë komunën që vendimmarrja jonë të jetë, kompatible ose në përputhje me kërkesat e qytetarëve dhe të gjitha palëve të tjera të interesit publik.

Tani këtë konsultim unë nuk po e zgjas më shumë, pak a shumë nëse do të ketë ndonjë pyetje specifike, fjala do të jetë e juaja të nderuar qytetarë, përfaqësues të OJQ-ve dhe të mediave të pranishëm të tjerë, dhe do ta bëjmë në formë bashkëbisedimi.

Ideja është që thjesht ne ju dëgjojmë ju, japim përgjigje aty ku kemi përgjigje, nëse ne përgjegjës e dimë me dhënë, lypim kohë prej juve dhe mirësinë e juaj që shkojmë e mësojmë pastaj në takime të tjera ose me shkrim ju përgjigjemi, por me rëndësi jemi të gati që të jemi bashkë me ju edhe sot edhe gjatë viteve në vijim.

Tani me një ngritje dore emër mbiemër që të protokollohet në proces urban mund ta merrni fjalën. Unë kam këtu edhe disa përfaqësues të tjerë të komisionit që e ka hartuar këtë draft dokument kemi edhe zonjën Eleanor Fetellari e cila ruan të drejtën që dokumentit të jetë në përputhje me dokumentat ose kërkesat e Bashkimit Europian, ku po synojmë që të shkojmë. Kështu që edhe këtë filtër e kemi kaluar domethënë gjatë këtij hartimi i këtij draft dokumenti dhe po mendoj që jemi duke bërë më të mirën të mundshme për momentin.

Nëse do fjalën dikush mund ta merrni.

## **Haki Reshtana**

Pershendetje per te gjithë!

Unë desha me përgëzuar punën që e bëni ju, zoti Berisha me ekipin e juaj. Unë jam i kënaqur me punën që bëni ju, por ka njerëz që nuk e shohin atë punën e juaj. Unë desha me cek transparencën për shembull për Prizrenin si multietnik problemi është që tash, nuk duhet me hy në histori. Kur jane festat shqiptare, kur janë festat shqiptare që i përkasin Shqipërisë ose 1878-ën, ajo është date që i përkasin komuniteti shqiptar, historia e tyre. Por problemi kur është dita e pavarësisë e që tash shpejt e kemi pase përgëzoi ditën e pavarësisë gjithë qytetarëve e Kosovës, por duhet edhe disa flamujt turq me pase.

Në këtë mungesë, shikoni, ajo është një diskriminim se ne si qytetarë të Kosovës kemi të drejtat me përdorur atë flamurin në Prizren, e kemi atë drejtë me kushtetutë. Disa herë e kam cekur po apert po po vazhdohet njejte. Kush e ka përgjegjësi për këto nuk mund me hyrë më thelle, por ju kishte lutur këto sende mos te ndodhin shpeshherë. E dini disa herë e kam kritikuar edhe atë ministrin para kësaj kohe edhe për Zambaku. Zambaku është diçka Histori kulturore e Prizrenit, gjithmonë ka pasur tre gjuhë edhe tre gjuhë këngë atje, me boshnjakët,

me turq, me shqiptarët bashkë kanë qenë. Ashtu që diçka me kthy në atë transparencë për Prizrenin, nuk po them për Kosovën, po po foli për Prizrenin.

### **Admir Bajrami**

Se pari ju përshëndes juve në punën e juaj dhe transparencën. Unë vetëm e kam një fjalë kështu në transparencën kur vijnë vendimet. Për shembull, çdo vendim duhet me ardhur në gjuhën boshnjake dhe turke. Këtu e keni pak një mangesi. Respekt për juve që publikoni në komunë, vendimet duhet me ardhur ne dy gjuhë atë kisha pasur dëshirë të jem dhe na ëh, lajmërim gjuhën boshnjake, kurr gjë tjetër. Ndërsa nuk kam kurrfarë fjalë për i nderuar Haziz Krasniqi që lajmëron, por kam fjalë për vendime të tjera ku vijnë për shembull, çdokush nuk vijnë në gjuhën boshnjake. Mbasi që janë boshnjak, këto e cek, kurr gjë tjetër. Faleminderit shumë.

### **Dashnor Vehapi**

Përshëndetje për të gjithë. Faleminderit për respektin se herë po, po vij në mbledhje, po ma japin fjalën. Ju përshëndes për punën, i përgëzoj për të gjitha, sa më shumë kritika prej neve, mendoj që ju do të punoni pak më shumë. I përshëndes dhe kolegët e mi dhe juve veç puna marrë. Faleminderit shumë.

### **Linda Simitçiu**

Atëherë përshëndetje për të gjithë. Fillimisht unë ndihem shumë mirë sot në këtë takim edhe di domethënë punën dhe angazhimin që e kanë bërë domethënë përveç juve edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile që i përmendat edhe ju vetë. Kam pasur rastin ta ta shikoj domethënë dokumentin edhe vërej asnjë që është me të vërtetë një punë shumë e mirë edhe uroj që ta gëzojtë gjithë banorët e komunës së Prizrenit. Faleminderit shumë.

### **Resmije Krasniqi-Shoqata Hader**

Përshëndetje. Ju përgëzoj për punën që e bëni komuna jonë. Unë desha t'ju them se këto personat që janë me të meta mendore dhe kudo që janë, kisha pasur dëshirë që këto persona të bëhen një grup punues që t'i vizitoj parket, t'i vizitoj shtëpitë ku janë ato persona të mirë. Deshta t'ju them edhe një herë për zotërinj, Sherif Çerimi, i cili është i vetëm te rruga Mehmet Hasi ju kisha lutur mos e lëni në vetëmij se vetë që ai nuk e di qysh jeton.

Do të bëhet ndonjë epidemi prej atij, se ajo është pa bukë, pastaj ne i çojmë si shoqata jonë, z.Beqir Ram ja dergon bukën. Është shtëpia e komuniteteve edhe ato ta çojnë diku, mos ta lënë ne vetmi, ai jeton vetem.Me vjen keq se këto persona pasi që i kam unë qëndrimin ditor tash, qëndrimi 24 orë ma kanë heq, kisha pasur dëshirë edhe t'ju kthej, mundësisht, këto personat që kemi ne nuk janë të kësaj komunës prej vendit, janë të Kosovës. Mos i dalloni ju lutna, bile rryma se po vjen shumë keq që po duhet me zgjedhe kforin turk ose dikend për me na ndihmu për shoqatat. Dhe vjen shumë keq se pasi që komuna bile rrymën përpara sadopak është paguar tash hiç 650 euro ka ardhur dhe ma kanë ndërprerë. E duhet taman puna të bëhet punë se do duhet me mbyrrr si komune,si një nënë e fëmijës me të meta 48 vjeçare e kqyri prej 99-tes deri tash 2025. Kërkush nuk i ka trazuar leprat i trazon leprat edhe të gatshme i çojnë nëpër shtëpinë e komuniteteve .Është hapur shtëpia e komuniteteve me personat e tonë, shoqatës, po më vjen mirë edhe mburren që ma ka dhënë Zoti një vullnet të mirë, një punë për mi kry për këto personat. Dhe sugjeroj, ju kisha lutur, mos i lëni nëpër parqe, se për këto vit po lindin fëmijë, shumë herë e kam cekur këtu. Ju lutna, bëni një punë qysh duhet, ose gjynah edhe ato. Vetëm kush e ka fëmijën me të, me ato po ja din, ose në familje që e kanë dikush me të meta ja din. Tash unë edhe një lutje e kam për Beqir Ramin. Ishalla do Zoti me paret e Beqirit 225 euro, ja kam blerë një ari 14 m<sup>2</sup> ju kisha lutur që komunitat ja ndërtojnë shtëpinë zotëriut, kërkesën e kam bërë. Ishalla do Zoti vjen mirë që janë këto qendrës dhe punës sociale këtu dhe shumë mirë punojnë, besoj që nuk e harrojnë Beqir Ramamin. Edhe prapë një sugjerim, ju kisha lutur që shoqata Hadër ta ket një donacion. Mjerim është, shoqata Hadër tash kemi mbetur shumë pak deri në maj me 225 euro rroga kryetares, e cila e nenshkruaj dhe ja jap zotëriut, cili psikologu vjen me 150 euro, 250 euro kujdestarja e cila i pastron fëmijët aty. Ju kisha lutur ta kqyrni shoqatën Hadër se në 99 atëherë s'ka pasur asnjë shoqatë e vetmja unë kam qene në Prizren dhe në Kosovë. Ju kisha lutur punoni tamam qysh duhet se na vjen gjynah për personat kur po vdesin që po ngrihet, vetëm një minut më falni. 2017 kur vdiq një person rrugës, atëherë erdhën te ne mendon se mos është e imja. Po jo shoqata hador i kanë ngritur, kanë përfituar shumë 205 anëtarë. Merre me mend edhe shko nëpër shtëpia edhe i këqyrim ato, i kemi rritur, i kemi bërë të gatshëm tash atje. E kam parë zotëriu Bashkimi i cili edhe unë i kam përcjellur Karanezëve atje se s'kam dashur me shkuar dhe kisha pasur dëshirë për me shkuar me i vizituar dhe me i çu ato fëmijë të tjerë. Besoj që do të kemi bisedim me zotëri Bashkimin qëndër për punë sociale ndoshta i kryen këtë punë. Edhe ju këto fjalë shtypninë vesh, dhe bisedoni me kryetarin që shoqata Hadër, a nuk ka këtu ndonjë urgjencë kështu ndonjë donacion për këto persona që mos t'i lënë kurqysh ne, edhe ato kanë nevojë për hir që s'na kanë paguar, e kanë hequr qëndrimin 24 orë. I falenderojmë shumë, na kanë kryer një pun të madhe. Ju jeni ligj, ju dilni shkambullin, mos i lëni rrugëve.

## **Bashkim Rakaj**

### **Përgjigje ndaj Resmije Krasniqi-Shoqata Hader**

Shoqara Hader është një vlerë për komunën e Prizrenit por kohët e fundit komuna e Prizrenit është e pakta ndër komunat në Kosovë që e ka objektin për personat me retardime mendore. Ne jemi në dijeni, personi në fjalë nuk i përket kategorisë që do të trajtohet rezidencial dhe gjatë vizitave nuk ka pranuar që të bëjë levizje për trajtim. Natyrisht që ka vështirësi. Shoqata Hader ka qenë top organizatë e cila ka pasë mbështetje nga komuna e Prizrenit. Sa i përket veteranit të luftës BEQIR RAMA po presim se shpejt do të fillojë projekti për ndërtimin e shtëpive do të jetë me prioritet por që e dimë që komuna financohet në bazë të disa rregulloreve dhe ligjeve. Sa i përket çështjes së vizitës së femijëve që je në kujdes që një kohë ska problem për vizitë, vetëm duhet me lënë takim me kujdestarin dhe gjithçka është në rregull.

## **Simon Veseli**

Përsëritet për të gjithë të pranishmit. Përsëritet për ju zotëri Ymeri, përsëritet Haziz. Kur flasim për transparencën, ftesa na ka ardhur me kohë për këtë takim për sot, por po befasohem që në këtë takim ne jemi diku 40-42 kryetarë të bashkësive lokale, po shoh më shumë ka të organizatave jo qeveritare të cilat po merren me problematikën e me nevojat e qytetarëve sesa na, tash po them edhe për vete, sesa ne që jemi të zgjedhur për me votën e popullit për me mbrojtë edhe interesat e qytetarëve por edhe për shërbime të tjera që kanë nevojë qytetarët. Kisha propozuar që me shikuar këtë fenomen, pse po na ndodh kështu? Pse jemi kaq të painteresuar në një mënyrë në bashkësi lokale? Pse këto takime nuk janë aq shpeshtë që na kanë lodhur, me thënë që jemi për çdo muaj, besoj që duhet me gjetur mundësinë për t'u takuar, për diskutuar, për të konsultuar, për të bashkëpunuar. Megjithatë unë kam ardhur me marrë pjesë këtu më sot në këtë pak me vonë, po kam dashur me mbështetur këtë projekt të transparencës, këtë mënyrë të transparencës e cila po bëhet vërtetë ndodh në qytetin e Prizrenit, edhe për të gjitha të tjerat jemi të informuar edhe përmes faqeve të internetit, nuk dua me ju marrë kohë më shumë, po kisha ju kisha lutur që të konsultoheni pak, bisedoni pak Hazizi ndoshta më me shumë kohë është më më i lidhur me kryetarët e bashkive lokale që me e ngritur pak vetëdijen e pjesëmarrjes së kryetarëve të bashkive lokale në kësi lloj takime për të parë se çka po ndodh rreth nesh edhe për ne edhe për qytetarët e komunës Prizren. Unë ju dëshiroj punë të marrë dhe suksese. Faleminderit


## **Faik Berisha**

Ju kisha bashkengjijt mendimit te kolegut Simon Veseli.Pasi qe vije nga Landovica,me rastin e pervjetorit te Pavaresise kemi pas mysafir nga vendet e ndryshme ne Varrezat e Landovices...Flamujte jane te demtuar dhe duhet pergjegjesit adekuate te merren me kete pune.Faleminderit!

Në këtë vegëz: <https://www.facebook.com/watch/?v=967799142115917&rdid=KmW4q7xsE8HasiGA> , mund të gjeni video incizimin e konsultimit publik.

**Konsultimi ka përfunduar në orën 11:40**

Procesmbajtës:





Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Lista e nënshkrimeve e anëtarëve të grupit punues për Hartimin e Projekt-Rregullores për  
Transparencë në Komunën e Prizrenit

Data e mbajtjes së takimit për shqyrtimin e komenteve: 06.03.2025.

Nr.	Emri	Mbiemri	Nr.Tel	Email	Gjinia	Nënshkrimi
1	Ymer	Prerifca	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
2	Erroll	Shubani	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
3	HARIZ	KRASHI	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
4	IRAIM	KUKA	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
5	Emine	Gashi	[REDACTED]	[REDACTED]	F	[Signature]
6						
7						
8						
9						
10						